

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-të e Këshillit të Agjencisë
për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 8. 2.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska,Goran Radunoviq,mr.Magdalena Davidovska Dogleva, Hari Mitrikeski Klekaçkoski, Teodora Ristovska, Sanja Gudeska Zdravkovska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 4-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski, lidhur me materialin shtesë për tri pikat që iu dorëzuan anëtarëve të Këshillit, sqaroi se do të shqyrtohen në seancë dhe do të përfshihen në rend dite. Të dyja kanë lidhje me tërmetin katastrofik që ndodhi në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë dhe do të vendoset menjëherë në procesverbal si Pika 3 - Propozim për miratim të vendimit për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, me propozim - vendim dhe Pika 4 - Propozim – vendim për dhënien ndihmë financiare – donacion për popullatën e prekur (dëmtuar) në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë nga tërmeti katastrofik dhe Propozim – marrëveshje për donacion. Pika e tretë me titull - Propozim-informacion drejtuar organit kompetent për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta për shkak të dyshimit se është kryer shkelje, propozohet të vendoset si pika 6.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi ndryshimin e mëposhtëm:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit të seancës së 1-rë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 27.1.2023.
2. Miratim i Propozim-Procesverbalit të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 27.01.2023.
3. Propozim për marrjen e vendimit për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, me propozim-vendim .
4. Propozim - vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për popullatën e prekur (dëmtuar) në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë nga tërmeti katastrofik dhe Propozim – kontratë për donacion.

5. Shqyrtimi i Raporteve Tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2022.
6. Propozim-informacion drejtuar organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta për shkak të dyshimit se është kryer shkelje .
7. Propozim-vendim për miratim të Raportit përfundimtar dhe Listave të regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022 .
8. Propozim për dhënie miratim për marrjen e vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në Sistemin e Shpërndarjes së Internetit të Regjistrimit Qendror .
9. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim nga Agjenci private për punësim.
10. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 1-rë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 27.1. 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 27.1.2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 3 dhe 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për marrjen e vendimit për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, me Propozim-vendim dhe Propozim-vendimin për dhënien e ndihmës financiare-donacion për popullatën e prekur (dëmtuar) në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë nga tërmeti katastrofik dhe Propozim-marrëveshje për donim. Ai shpjegoi se Plani Financiar i Agjencisë do të zgjerohet për 1.000.000,00 denarë, sepse është fillimi i vitit dhe furnizimet publike ende nuk janë realizuar që të mund të sigurohen këto mjete për donacion për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti. Lidhur me vendimin e propozuar për donim, ai shpjegoi se shuma është 1 milion denarë, ndërsa mjetet do të transferohen në përputhje me Kontratën (marrëveshjen) për donacion të Kryqit të Kuq në RMV - Fondi i Solidaritetit dhe prej aty do të ndahen si ndihma për popullatën e prekur (dëmtuar). Ai theksoi se Marrëveshja (kontrata) për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Kryqit të Kuq të RMV-së është dorëzuar si shtojcë (bashkëngjitje) të materialeve, e cila do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese dhe do të aplikohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Z. Petrushevski shprehu keqardhje që në vitet e fundit ka pasur disa donacione të tilla nga Agjencia, si ishte për Greqinë dhe Shqipërinë. Ai shpjegoi se dhe këtë herë problematika është e ngjashme dhe shuma e donacionit.

Z. Fidanoski tha se do të diskutojë për të dyja pikat. Nuk ka ngushëllim për përjetimet në një situatë të tillë kataklizmike. Ai tha se skenat janë vërtet të tmerrshme dhe shpreson se ekipet e shpëtimit do të jenë në gjendje të tërhiqen dhe të shpëtojnë sa më shumë që të jetë e mundur jetë njerëzish nga tërmetet e njëpasnjëshme (seri shkatërruese e tërmeteve). Si banorë të qytetit ku shumica prej nesh jetojnë, në kryeqytetin e Shkupit, duhet të tregohet solidaritet sepse 60 vjet më parë edhe Shkupi u godit nga një tërmet i ngjashëm katastrofik. Në këtë drejtim, ai tha se nuk ka absolutisht asnjë arsye pse të mos votojë për një ndihmë të tillë, siç e kanë bërë deri tani edhe në shumë raste të tjera. Ai deklaroi se do të mbështesë donacionin. Ai deklaroi se do të jap një vërejtje formale teknike gjuhësore në lidhje me emrin e njëres prej shteteve ku do të dërgohet ndihma, gjegjësisht nuk është Republika Turke sepse transkriptimi cirilik dhe shkrimi kalimtar në gjuhën maqedonase është Republika e Turqisë. Për këto arsye ai sugjeroi që të korrigohet kudo që shfaqet në material.

Z. Ajdini shprehu ngushëllimet e tij të thella për familjarët e të humburve dhe të prekurve (dëmtuarve) nga tërmeti në Turqi dhe Siri. Mirë është që Agjencia, si në një sërë rastesh të tjera që solidarizohet dhe donon ndihmë financiare. Ai shpreh me të vërtetë keqardhje për jetët e humbura dhe sipas informacioneve të fundit numri i të vdekurve ka shkuar në 11 mijë, madje mund dhe që të rritet. Ai deklaroi se do të mbështesë donacionin e propozuar.

Z. Petrushevski tha se do t'i rikthehet vërejtjes së z. Fidanoski. Shpjegimi i tij se në maqedonisht duhet të quhet ende Republika e Turqisë dhe se Republika Turke është origjinali (fillimisht) në gjuhën turke. Ai e di se Turqia u kërkoi dhe vendeve të tjera ta quanin Turke për shkak të fjalës angleze për gjelin e detit dhe ndoshta kjo është arsyeja që ata kërkuan të ndryshonin emrin. Ai kërkoi mendimin e drejtorit në lidhje me vërejtjen nga z. Fidanoski.

Z. Trajçevski shpjegoi se vitin e kaluar emri është ndryshuar edhe në OKB, është përshtatur edhe në kushtetutën e tyre. Pas konsultimeve të bëra është marrë informacion se duhet përdorur ai emër, pra emri zyrtar i shtetit është Republika Turke.(Turkye). Por ai tha se do të bëhen kontrole shtesë.

Z. Petrushevski sqaroi se Këshilli do t'i votojë këto dokumente, përkatësisht do t'i miratojë dhe drejtori do t'i aprovon.

Z. Fidanoski shpjegoi se ndryshimi i emrit në OKB është emri ndërkombëtar i shtetit për korrespondencë të përgjithëshme sepse deri atëherë përdorej transkriptimi në anglisht i emrit e cila për arsye të shpjeguara dhe nga vetë shteti ishte ofendues për ta sepse shpeshherë ishte krahasuar me emrin anglez të një shpendi (zogu). Për këto arsye, ata insistuan në transkriptim të shkruhet ashtu siç ata e adresojnë. Mirëpo në Maqedoni gjuha zyrtare është maqedonishtja, kurse në transkriptimin cirilik në e quajmë Shteti i Turqisë dhe kjo nuk është ofenduese për ta. Mund të vëreni edhe në shtetet përreth si është transkriptimi, domethënë askush në shtetet përreth nuk e quan Turke, por siç e quanin dikur, sepse nuk është emër ofendues për ta. Për këto arsye, ai konsideron se është mëse e drejtë Turqi, për të cilën mund të konsultohen ekspertë, lektorë dhe ligjërues të gjuhës maqedonase, se a është e drejtë të qëndrojnë Republika e Turqisë.

Z. Petrushevski propozoi që të mos humbet kohë duke diskutuar për emrin dhe të votohen pikat dhe mundësisht të kontrollohet emri me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe

lektorë se a duhet të shkohet me Turqi ose Turkie si është e saktë. Për ndryshe, ai tha se personalisht e quan Turqi.

Z. Jaçeski shpjegoi se në anglisht quhet "Turkie" dhe për shkak të emërimit anglez, siç tha edhe z. Fidanoski, ne nuk e quajmë Turki, kështu që tani ta quajmë Turkie, por e quajmë Republika e Turqisë . Kjo fjalë për fjalë është në përputhje me emrin e ri. Ai theksoi se jo saktësisht ministrinë do të kenë një zgjidhje ideale dhe nuk duhet të mbështetemi në mendimin e tyre, prandaj mendon se për këtë duhet të konsultohen gjuhëtarët.

votimi sipas pikës 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e rritjes së Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, nr. 05-4716/1 datë 22.12.2022 .

Të ardhurat dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023 do të rriten për 1.000.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në 149.530.505,00 denarë.

Rritja e propozuar do të sigurojë mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 1.000.000,00 denarë, të destinuara për:

- Ndarje të ndihmës së njëhershme financiare për - Donacion për popullatën e dëmtuar në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë, të prekur nga tërmeti katastrofik më datë 6.2.2023 në shumë prej 1.000.000,00 denarë .

Obligohet Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit që vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

votimi sipas pikës 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për dhënien (ndarjen) e ndihmës financiare - donacion për popullatën e prekur (dëmtuar) në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë nga tërmeti katastrofik i datës 6.2.2023, në shumën 1.000.000.00 (një milionë) denarë, të cilat do të realizohen përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), si pranues i donacionit, Fond i veçantë për solidaritetit.

Mjetet e lartpërmendura janë të ndara nga fondet financiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të siguruara nga plani financiar i Agjencisë për vitin 2023 dhe derdhen në llogarinë e posaçme të dedikuar të Kryqit të Kuq të RMV – Fondi i Solidaritetit përmes Bankës Komerciale, numri i llogarisë 300000001327966, numri tatimor 4030984271620.

Për ndihmën financiare-donacion të dhënë nga Vendimi i mësipërm për popullatën e prekur në Republikën e Turqisë dhe Republikën Arabe të Sirisë nga tërmeti katastrofik i datës 6.2.2023, është lidhur Marrëveshja për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Kryqit të Kuq të RMV-së, e cila do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb-faqen e internetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale .

Pika 5

Z. Petrushevski, në lidhje me Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 tetori deri më 31 dhjetor 2022, tha se në materialet janë shënuar aktivitete të shumta të Agjencisë gjatë kësaj periudhe. Ai veçoi Ditët e Arsimimit Mediatik si aktivitet i shkëlqyer i ASHMA-së dhe i cili shkoi mirë, më pas Takimin rajonal për 25 vjetorin e ASHMA-së i cili po ashtu shkoi mirë. Së treti, ai tha se vlerëson dhe numrin vërtet të madh të aktiviteteve ndërkombëtare të Agjencisë. Por ai tha se si punë negative do të veçonte shumicën e sjelljeve të papëlqyera të zyrtarëve dhe politikan të caktuar ndaj mediave dhe gazetarëve. Ai shpjegoi se incidente të tilla ka pasur edhe më parë, por në një numër kaq të madh asnjëherë më parë. Ai shpreson se nuk do të përsëriten në periudhën e ardhshme, sepse nëse vazhdojnë ofendime të tilla përveç numrit të madh të paralajmërimeve do të duhet të ndërmerret diçka, qoftë ndonjë edukim shtesë, sepse raste të tilla ka pasur në mënyrë të vazhdueshme muajt e fundit të vitit.

Z. Fidanoski tha se do të ndërlidhet me pjesën e fundit të deklaratës së z. Petrushevski. Sjellje të tilla të pahijshme ka pasur dhe do të ketë në këtë hapësirë. Ai pajton se ato u bënë më të shpeshta gjatë kësaj periudhe ndoshta për shkak të folklorit politik që ekziston në vendin tonë dhe në vendet përreth. Neve na takon të reagojmë siç është bërë deri më tani, që në kohë të vihen në dukje se sjellje të tilla nuk janë të pranueshme ndaj mediave si mbrojtëse të interesit publik. Deri më tani Agjencia po e kryen punën e saj mirë dhe e gjithë kjo mund të kontrollohet në ueb-faqen e ASHMA-së se sa reagime të tilla ka. Për sa i përket aktiviteteve të Agjencisë, ai u pajtua se Raportet tremujore me fakte dhe informacione janë mjaft të pasura, por kjo nuk është hera e parë, ata tashmë janë mësuar me aktivitete kaq dinamike të rregullatorit, detyrimet e tyre gjithmonë i përmbushin në tërësi dhe besoj se kjo do të vazhdojë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi Propozim-informacionin drejtuar organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta për shkak të dyshimit se është kryer shkelje. Ajo shpjegoi se propozimi drejtuar Këshillit është që të dorëzohet Informacioni që është dhënë si shtojcë në materialet e dorëzuara në Ministrinë e Punëve të Brendshme – Qendra për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe të Rënda për faktin se gjatë ditës së djeshme TV Telma ka paraqitur Kërkesë në Agjenci për të ndërmarrë veprimet e duhura në lidhje me konstatimin e ritransmetimit të paautorizuar dhe të paligjshëm të një pjese të përmbajtjeve programore të TV Telmës nga EON TV International Ltd, person juridik i regjistruar në Qipro. Kërkesa e TV Telma si dhe Procesverbali për vërtetimin e fakteve janë dorëzuar në material sipas pikës dhe të njëjtat si shtojcë ndaj informacionit do t'i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Agjencisë, në bazë të Kërkesës së pranuar për konstatimin e ritransmetimit të paautorizuar dhe të kundërligjshëm të një pjese të përmbajtjes programore të SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP TELMA Shkup nga EON TV International Ltd, (Nr. ynë 03-666/1 të datës 7.2.2023) me të cilin TV Telma kërkon nga Agjencia të ndërmarrë veprimet

e duhura në lidhje me fillimin e procedurës për kallëzim penal të dorëzuar në Prokurorinë Themelore Publike, njëzëri vendosi në Ministrinë e Punëve të Brendshme – Qendra për Ndalimin e Krimit të Organizuar dhe të Rëndë të dorëzojë Informacionin për ekzistimin e dyshimit për shkeljen e kryer të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta nga operatori personi juridik EON TV International Ltd, Limassol Kipar , me tekstin e propozuar.

Pika 7

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozim-vendimin për miratimin e Raportit përfundimtar dhe Listave të regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, sqaroi se Këshilli jep miratim ndërsa drejtori sjell Vendim për miratimin e Raportit dhe të gjitha vendimeve të tjera që dalin nga këtu.

Trajçevski shpjegoi se do të bëjë një hyrje, por meqë në seancë është përfshirë edhe komisioni i regjistrimit mund të përgjigjen në pyetje më të detajuara nëse ka. Në përputhje me detyrimet ligjore Komisioni i Regjistrimit brenda afatit të caktuar ka bërë regjistrimin e mjeteve monetare, artikujve, pajisjeve, inventarit të imët dhe kërkesave dhe detyrimeve, asetëve bazë, materialeve dhe pjesëve rezervë në magazinë dhe mjeteve monetare të Agjencisë. Agjencia posedon dy llogari në denarë në SHA Banka Komerciale Shkup. Sipas inventarit të kryer sipas çertifikatave bankare, shuma e përgjithshme e mjeteve në këto llogari më 31.12.2022 është 137.101.802,00 denarë. Gjendja e mjeteve monetare në denarë dhe kasafortën devize në tërësi i përgjigjet gjendjes më 31.12.2022, sipas ditarit në denarë dhe deviz të kasafortës. E njëjta gjë vlen edhe për stokimin e materialeve në magazinë. Është kryer regjistrimi i mjeteve (asetëve) bazë dhe inventari i imët dhe me konstatimin e gjendjes fiktive është konstatuar se ato korrespondojnë me listat e pranuar. Si shtojcë e regjistrimit është dhënë dhe listë për çregjistrim për shkak të vjetërsimit. Lista për çregjistrim është me propozimin e Sektorit për Mbështetje Informative dhe punë të përgjithëshme. Totali i kërkesave i Agjencisë më 31.12.2022 është 2.876.873,00 denarë. Nga mjetet e deklaruara, 334.022,00 denarë i referohen kërkesave nga viti 2022. Në periudhën prej 30 janar 2023 nga këto kërkesa janë paguar 275.692,00 denarë. Kërkesat e mbetura janë kërkesa të vjetra për të cilat janë nisur procedurat përkatëse për parapagesën e tyre. Kërkesa më e madhe nga kërkesat e vjetra është nga Kompania ERA në shumë prej 1.810.260,00 denarë. Kjo kërkesë parapagohet (arkëtohet) përmes një përmbaruesi me mbajtje mujore të mjeteve nga person fizik. Totali i obligimeve të Agjencisë më 31.12.2022 ishte 1.940.498,00 denarë . Deri në janar 2023, nga obligimet e deklaruara janë paguar fatura në vlerë prej 1.753.421,00 denarë. Ai theksoi se nëse kanë pyetje, është këtu komisioni i regjistrimit për t'u përgjigjur për informacion më të detajuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratimin Drejtorit të Agjencisë për aprovimin e Vendimit për miratimin e Raportit përfundimtar për regjistrimin e kryer (të artikujve, pajisjet, materialet harxhuese, inventarin e imët dhe pretendimet dhe detyrimet, mjetet bazë, materialet dhe pjesët e këmbimit në depo dhe paratë e gatshme të Agjencisë) dhe Listat e regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjenci për vitin 2022, të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe për çregjistrim të mjeteve bazë, me tekst siç është propozuar në vendim.

Me vendim u miratua Raporti përfundimtar për regjistrimin e kryer (të objekteve, pajisjeve, materialeve shpenzuese, inventarit të imët dhe kërkesave dhe detyrimeve, mjeteve bazë, materialeve dhe pjesëve të këmbimit në depon e Agjencisë dhe mjeteve financiare

(parave të gatshme) dhe Listave të regjistrimit nga inventari i kryer në Agjenci për vitin 2022 të cilat dorëzohen si shtojcë të Raportit të përfunduar, përkatësisht:

- Lista e inventarit të gjendjes së konstatuar të mjeteve në denarë dhe mjeteve në valutë, e cila i bashkëngjitet Raportit të përfunduar si Shtojca nr.1;

- Lista e inventarit të materialeve në magazinë - materialet harxhuese, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojca nr. 2;

- Lista e inventarit të mjeteve (aseteve) fikse (inventar dhe pajisje), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojca nr. 3, me listë të veçantë të inventarit për mjetet fikse që nuk gjenden në Shkup, dhe me listë inventarizimi për gjendjen e konstatuar të ekzistimit të pasurisë së një subjekti tjetër (pasuria e tjetrit), e cila i bashkëngjitet Raportit Përfundimtar si Shtojca nr. 3A;

- Lista e inventarit me propozim për fshirje/shpenzim të inventarit dhe pajisjeve dhe për inventar të imët, (vogël), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojca nr. 4;

- Lista e inventarit të kërkesave dhe detyrimeve, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojca nr. 5; dhe

- Lista e inventarit për inventar të imët (vogël), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojca nr. 6.

Për të kryer fshirjen e mjeteve bazë, të përfshira në Listën e inventarit për fshirjen/shpenzimet e inventarit dhe pajisjeve që i bashkëngjitet Raportit përfundimtar (si Shtojca nr. 4), thuhet në pikën 1 alinea 4 të Vendimit.

Fondet e fshira duhet të bien mbi barrën e kapitalit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 8

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për miratimin e mjeteve në shumë prej 30.000,00 denarë me qëllim të mundësimit të qasjes së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në të dhënat e sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror të RMV-së, me të cilin do të krijohen kushte për përmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve që për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të parapara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 42/20 dhe 77/21) dhe në Ligjin për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14).

Fondet e mësipërme sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2023.

Pika 9

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim nga agjencion privat për punësim. Ai ka shpjeguar se me këtë furnizim publik punësohen njerëz për nevojat e Agjencisë dhe çdo vit shumica e mjeteve për

furnizim publik nuk realizohen përveç në rastet kur ka zgjedhje. Angazhimi më i madh ndodh gjatë kohës së zgjedhjeve kur në fakt ka më së shumti aktivitete për shkak të periudhës zgjedhore. Megjithatë, Agjencia duhet të jetë gjithmonë e gatshme në rast se ka zgjedhje, por mjetet financiare për punësimin e personave nga Agjencia e Punësimit mbulohen nga buxheti me vendim të Qeverisë. Ai tha se nëse ka nevojë në lidhje me procedurën, sqarim mund të na japë Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe Furnizim publik, Cvetanka Mitrevska.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik – Shërbim nga Agjenci private për punësim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - Shërbim nga Agjenci private për punësim në periudhë prej 1 (një) viti është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12. 2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 10

Të ndryshme

Nuk ka diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-647/8

15.02.2023
Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v